Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës,

duke dashur të përfundojnë një protokoll ndryshues, të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për shmangien e tatimit të dyfishtë, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin, dhe për parandalimin e evazionit fiskal (në vijim e referuar si "Marrëveshja"),

kanë renë dakord, si më poshtë:

Neni 1

Preambula e marrëveshjes hiqet dhe zëvendësohet, si vijon:

"Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës,

me dëshirën për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të tyre ekonomike dhe përmirësimin e bashkëpunimit të tyre në çështjet tatimore,

duke synuar të lidhin një Marrëveshje për eliminimin e tatimit të dyfishtë për tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin, pa krijuar mundësi për mos tatim ose tatim të reduktuar, përmes evazionit apo shmangies tatimore (duke përfshirë marrëveshjet që synojnë marrjen e lehtësirave të parashikuara në këtë Marrëveshje, për përfitimin indirekt të rezidentëve të Shteteve të treta), kanë rënë dakord si më poshtë:".

Neni 2

Në nenin 1 "Personat e përfshirë", shtohen paragrafët 2 dhe 3, me këtë përmbajtje:

"2. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, të ardhurat që rrjedhin nga apo përmes një subjekti apo marrëveshjeje që trajtohet si pjesërisht apo tërësisht transparente nga aspekti fiskal, sipas ligjeve tatimore të secilit Shtet Kontraktues, konsiderohen të jenë të ardhura të një rezidenti të një Shteti Kontraktues, por vetëm në masën që e ardhura trajtohet për qëllime të tatimit nga ai Shtet, si e ardhur e rezidentit të atij Shteti.

3. Kjo marrëveshje nuk cenon tatimin nga një Shtet Kontraktues, të rezidentëve të tij, përveç në lidhje me përfitimet e dhëna sipas paragrafit 3, të nenit 7, paragrafit 2 të nenit 9 dhe neneve 18, 19, 22, 23, 24 dhe 27".

Neni 3

Në nenin 10 "Dividendët", shtohet paragrafi 1.1 me këtë përmbajtje:

"1.1 Megjithatë, këta dividendë mund të tatohen edhe në Shtetin Kontraktues, ku shoqëria paguese e dividendëve është rezidente dhe në përputhje me ligjet e këtij Shteti, por nëse pronari përfitues i devidendëve është rezident i Shtetit tjetër kontraktues, tatimi i ngarkuar nuk do të tejkaloj:

a) 5 për qind të shumës bruto të devidendëve, nëse pronari përfitues është një shoqëri (përveç nëse është partneritet), e cila drejtpërsëdrejti mban së paku 25 për qind të kapitalit të ndërmarrjes që paguan dividendët gjatë një periudhe 365-ditore, që përfshin ditën e pagesës së devidendit (për qëllim të llogaritjes së një periudhe të tillë, nuk merren parasysh ndryshimet e pronësisë që do të rezultonin drejtpërdrejt nga një riorganizim korporativ, i tillë si bashkim shoqërish ose riorganizim ndarës i shoqërisë që mban aksionet ose paguan dividendin);

b) 8 për qind të shumës bruto të devidendëve në të gjitha rastet e tjera.

Autoritetet kompetente të Shteteve kontraktuese vendosin me marrëveshje të përbashkët mënyrën e zbatimit të këtyre kufizimeve. Ky paragraf nuk ndikon në tatimin e shoqërisë në lidhje me fitimet nga të cilat paguhen dividendët.".

Neni 4

Në nenin 12 "Të ardhurat nga e drejta e pronësisë", bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- Paragrafi 1, zëvendësohet me këtë përmbajtje:

"1. Të ardhurat nga e drejta e pronësisë që krijohen në një Shtet Kontraktues dhe i paguhen

një rezidenti të Shtetit tjetër kontraktues mund të tatohen në atë Shtet tjetër.".

- Shtohet paragrafi 1.1 me këtë përmbajtje:

"1.1 Megjithatë, e ardhura nga e drejta e pronësisë mund të tatohet edhe në Shtetin kontraktues në të cilin krijohen dhe sipas ligjeve të atij Shteti, por nëse pronari përfitues i të drejtave të pronësisë është rezident i Shtetit tjetër kontraktues, tatimi i vendosur nuk tejkalon 10 për qind të shumës bruto të të drejtave të pronësisë.".

- Shtohet paragrafi 3.1 me këtë përmbajtje:

"3.1 Të ardhurat nga e drejta e pronësisë konsiderohen të lindin në një Shtet Kontraktues kur paguesi është rezidenti i atij Shteti. Megjithatë, nëse personi që paguan të ardhurat nga e drejta e pronësisë, qoftë rezident i Shtetit Kontraktues apo jo, ka në një Shtet Kontraktues seli të përhershme ose bazë fikse, në lidhje me të cilën ka ndodhur detyrimi për të paguar të ardhurat nga e drejta e pronësisë, dhe këto të ardhura mbulohen nga kjo seli e përhershme ose bazë fikse, atëherë të ardhurat nga e drejta e pronësisë konsiderohen të lindin në Shtetin në të cilin ndodhet selia e përhershme ose baza fikse.".

Neni 5

Në nenin 25 "Shkëmbimi i informacionit", shtohen paragrafët 4 dhe 5, me këtë përmbajtje:

"4. Nëse informacioni kërkohet nga një Shtet Kontraktues, në përputhje me këtë nen, Shteti tjetër Kontraktues do të përdorë masat e tij për mbledhjen e informacionit për të marrë informacionin e kërkuar, pavarësisht se Shteti tjetër mund të mos ketë nevojë për këtë informacion për qëllimet e veta tatimore. Detyrimi i përfshirë në fjalinë e mësipërme i nënshtrohet kufizimeve të paragrafit 3, por në asnjë rast këto kufizime nuk do të interpretohen se lejojnë një Shtet Kontraktues të refuzojë të sigurojë informacione, vetëm sepse nuk ka interes të brendshëm për këtë informacion.

5. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafit 3 nuk mund të interpretohen se lejojnë një Shtet Kontraktues të refuzojë, të sigurojë informacion vetëm sepse informacioni mbahet nga një bankë, institucion tjetër financiar, i caktuar ose një person që vepron në një agjenci ose një aftësi për të mbajtur në besueshmëri ose sepse lidhet me interesat e pronësisë te një person.".

Neni 6

Pas nenit 26 "Asistenca për mbledhjen e tatimeve", shtohet neni 26/1 "E drejta për përfitime", me këtë përmbajtje:

"Neni 26/1
E drejta për përfitime

1. Pavarësisht nga dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje, një përfitim sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të jepet në lidhje me një zë të të ardhurave ose kapitalit, nëse është e arsyeshme të arrihet në përfundimin, duke marrë parasysh të gjitha faktet përkatëse dhe rrethanat, se marrja e këtij përfitimi ishte një nga qëllimet kryesore të çdo marrëveshjeje ose transaksioni që rezultoi drejtpërdrejt ose indirekt në atë përfitim, përveçse nëse përcaktohet se dhënia e këtij përfitimi në këto rrethana do të ishte në përputhje me objektin dhe qëllimin e dispozitave përkatëse të kësaj Marrëveshjeje.

2. Kur një përfitim sipas kësaj Marrëveshjeje i mohohet një personi, sipas paragrafit 1, autoriteti kompetent i Shtetit Kontraktues që do ta kishte dhënë këtë përfitim, gjithsesi do ta trajtojë atë person sikurse ai ka të drejtë për këtë përfitim, ose për përfitime të ndryshme në lidhje me një zë specifik të të ardhurave ose kapitalit, nëse një autoritet i tillë kompetent, me kërkesë nga ai person dhe pas marrjes parasysh të fakteve dhe rrethanave përkatëse, përcakton se këto përfitime do t'i ishin dhënë atij personi në mungesë të transaksionit ose marrëveshjes së përmendur në paragrafin 1. Autoriteti kompetent i Shtetit Kontraktues, tek i cili është bërë kërkesa, do të konsultohet me autoritetin kompetent të Shtetit tjetër, përpara se të refuzojë një kërkesë të bërë sipas këtij paragrafi nga një rezident i atij Shteti tjetër.".

Neni 7

1. Ky protokoll do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike, me anë të së cilave Shtetet Kontraktuese konfirmojnë përfundimin e procedurave të brendshme ligjore të kërkuara për hyrjen në fuqi të këtij protokolli.

2. Dispozitat e këtij protokolli do të kenë efekt për sa i përket viteve tatimore që fillojnë më ose

pas ditës së parë të muajit janar të vitit kalendarik, që vijon pas vitit në të cilin protokolli hyn në fuqi.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, të autorizuar sipas rregullave, kanë nënshkruar këtë protokoll.

Bërë në Tiranë më 2.10.2020, në dy kopje në gjuhën shqipe, të dyja tekstet autentike.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Anila Denaj
Ministre

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS
SË KOSOVËS
Hykmete Bajrami
Ministre

DEKRET
Nr. 11969, datë 18.2.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe të nenit 93, të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 12/2021, "Për ratifikimin e protokollit ndryshues të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për shmangien e tatimit të dyfishtë, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin, dhe për parandalimin e evazionit fiskal, ratifikuar me ligjin nr. 62/2014".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 14/2021

PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT NDRYSHUES TË MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË DUKATIT TË MADH TË LUKSEMBURGUT, PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL, LIDHUR ME TATIMET MBI TË ARDHURAT DHE KAPITALIN, E NËNSHKRUAR NË TIRANË, MË 14 JANAR 2009, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 10094, DATË 12.3.2009

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet protokolli ndryshues i marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut, për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin, e nënshkruar në Tiranë, më 14 janar 2009, ratifikuar me ligjin nr. 10094, datë 12.3.2009, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 1.2.2021.

Shpallur me dekretin nr. 11971, datë 18.2.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

PROTOKOLL NDRYSHUES
I MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË DUKATIT TË MADH TË LUKSEMBURGUT, PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL, PËR TATIMET MBI TË ARDHURAT DHE KAPITALIN, E NËNSHKRUAR NË TIRANË, MË 14 JANAR 2009

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut,

duke dashur të përfundojnë një Protokoll ndryshues të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut për Shmangien e Tatimit të Dyfishtë dhe Parandalimin e Evazionit Fiskal për Tatimet mbi të Ardhurat dhe Kapitalin, e nënshkruar në Tiranë, më 14 janar 2009 (në vijim e referuar si "Marrëveshja"),

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Preambula e Marrëveshjes hiqet dhe zëvendësohet si vijon:

"Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut,

duke dashur të zhvillojnë më tej marrëdhëniet e tyre ekonomike dhe të rrisin bashkëpunimin e tyre në çështjet tatimore;

duke synuar të lidhin një Marrëveshje për eliminimin e tatimit të dyfishtë për tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin, pa krijuar mundësi për mostatim ose tatim të reduktuar përmes evazionit apo shmangies tatimore (duke përfshirë marrëveshjet, që synojnë marrjen e lehtësirave të parashikuara në këtë Marrëveshje, për përfitimin indirekt të rezidentëve të shteteve të treta),

kanë rënë dakord si më poshtë:".

Neni 2

Neni 26 (Shkëmbimi i informacionit) i Marrëveshjes hiqet dhe zëvendësohet si vijon:

"Neni 26
Shkëmbimi i informacionit

1. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të shkëmbejnë informacionin e nevojshëm, siç parashikohet përkatësisht për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje ose për administrimin ose për zbatimin e ligjeve të brendshme, në lidhje me tatimet e çdo lloji dhe përshkrimin e vendosur në emër të Shteteve Kontraktuese ose të autoriteteve të tyre lokale, në atë masë që këto tatime të mos jenë në kundërshtim me Marrëveshjen. Shkëmbimi i informacionit nuk kufizohet nga nenet 1 dhe 2.

2. Çdo informacion i marrë, sipas paragrafit 1, nga një Shtet Kontraktues do të trajtohet si konfidencial në të njëjtën mënyrë si informacioni i përftuar, sipas ligjeve të brendshme të atij Shteti dhe do të jepet vetëm për personat ose autoritetet (duke përfshirë gjykata dhe organe administrative), që merren me vlerësimin ose mbledhjen, zbatimin ose procedimin, në lidhje me/ose përcaktimin e apelimeve rreth tatimeve të referuara në paragrafin 1 ose mbikëqyrjen e sa më lart. Këta persona ose autoritete do të përdorin informacionin vetëm për këto qëllime. Ata mund të japin informacionin në procedime seancash gjyqësore me dyer të hapura ose në vendime gjyqësore. Pavarësisht nga sa më sipër, informacioni i marrë nga një Shtet Kontraktues mund të përdoret për qëllime të tjera, kur një informacion i tillë mund të përdoret për qëllime të tjera, sipas ligjeve të të dyja shteteve dhe kur autoriteti kompetent i shtetit që jep informacionin autorizon një përdorim të tillë.

3. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të interpretohen si të tilla që të vendosin mbi një Shtet Kontraktues detyrimin:

a) për të realizuar masa administrative në mospajtim me ligjet dhe praktikën administrative të atij Shteti Kontraktues ose të Shtetit tjetër Kontraktues;

b) të japin informacion që nuk është i arritshëm sipas ligjeve ose në punën normale të administratës së atij Shteti Kontraktues apo të Shtetit tjetër Kontraktues;

c) të japin informacion që do të zbulonte çdo sekret tregtar, biznesi, industrial, tregtar ose profesional, ose proces tregtie apo informacion, zbulimi i të cilit do të ishte në kundërshtim me politikën publike (rendin publik).

4. Nëse informacioni kërkohet nga një Shtet Kontraktues, në përputhje me këtë nen, Shteti tjetër Kontraktues do të përdorë masat e tij për mbledhjen e informacionit, për të marrë informacionin e kërkuar, pavarësisht se Shteti tjetër mund të mos ketë nevojë për një informacion të tillë për qëllimet e veta të tatimit. Detyrimi i përfshirë në fjalinë e mësipërme u nënshtrohet kufizimeve të paragrafit 3, por në asnjë rast këto kufizime nuk do të interpretohen se lejojnë një Shtet Kontraktues të refuzojë të japë informacion vetëm, sepse nuk ka interes të brendshëm për një informacion të tillë.

5. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafit 3 nuk do të interpretohen se lejojnë një Shtet Kontraktues të refuzojë të sigurojë informacion vetëm sepse informacioni mbahet nga një bankë, institucion tjetër financiar, person i emëruar ose një person që vepron në një agjenci ose në mirëbesim ligjor, ose sepse lidhet me interesat e pronësisë së një personi.".

Neni 3

Neni i mëposhtëm 27A (E drejta e përfitimeve) shtohet në Marrëveshje pas nenit 27:

"Neni 27 A
E drejta e përfitimeve

1. Pavarësisht nga dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshje, një përfitim sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të jepet në lidhje me një zë të të ardhurave ose të kapitalit, nëse është e arsyeshme të arrihet në përfundimin, duke marrë parasysh të gjitha faktet përkatëse dhe rrethanat, se marrja e këtij përfitimi ishte një nga qëllimet kryesore të çdo marrëveshjeje ose transaksioni që rezultoi drejtpërdrejt ose indirekt në atë përfitim, përveçse nëse përcaktohet se dhënia e këtij përfitimi në këto rrethana do të ishte në përputhje me objektin dhe qëllimin e dispozitave përkatëse të kësaj Marrëveshjeje.

2. Kur një përfitim sipas kësaj Marrëveshjeje i mohohet një personi, sipas paragrafit 1, autoriteti kompetent i Shtetit Kontraktues, që do ta kishte dhënë këtë përfitim, gjithsesi do ta trajtojë atë person sikurse ai ka të drejtë për këtë përfitim ose për përfitime të ndryshme në lidhje me një zë specifik të të ardhurave ose të kapitalit, nëse një autoritet i tillë kompetent, me kërkesë nga ai person dhe pas marrjes parasysh të fakteve dhe të rrethanave përkatëse, përcakton se këto përfitime do t'i ishin dhënë atij personi në mungesë të transaksionit ose të marrëveshjes së përmendur në paragrafin 1. Autoriteti kompetent i Shtetit Kontraktues, tek i cili është bërë kërkesa, do të konsultohet me autoritetin kompetent të Shtetit tjetër, përpara se të refuzojë një kërkesë të bërë sipas këtij paragrafi nga një banor i atij Shteti tjetër.".

Neni 4

1. Ky Protokoll do t'i nënshtrohet ratifikimit, në përputhje me procedurat në fuqi në Shqipëri dhe në Luksemburg. Shtetet Kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim, përmes kanaleve diplomatike, kur të kenë përfunduar procedurat e tyre përkatëse të zbatueshme.

2. Protokolli hyn në fuqi në datën e marrjes nga pala e fundit të njoftimeve të përmendura në paragrafin 1. Dispozitat e këtij Protokolli do të kenë efekt për sa u përket viteve tatimore që fillojnë më ose pas ditës së parë të muajit janar të vitit kalendarik, që vijon pas vitit në të cilin Protokolli hyn në fuqi.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, të autorizuar sipas rregullave, kanë nënshkruar këtë Protokoll.

Bërë në dy kopje, në Luksemburg, më 21.10.2020, në gjuhët shqipe dhe frënge, të dyja tekstet autentike.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË	PËR QEVERINË E DUKATIT TË MADH TË LUKSEMBURGUT
Suela Janina AMBASADOR	**Pierre Gramegna** MINISTËR I FINANCAVE

DEKRET
Nr. 11971, datë 18.2.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe të nenit 93, të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 14/2021, "Për ratifikimin e protokollit ndryshues të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut, për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin, e nënshkruar në Tiranë, më 14 janar 2009, ratifikuar me ligjin nr. 10094, datë 12.3.2009".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 18/2021

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR HUAN PËR ZHVILLIMIN E POLITIKËS PËR QËNDRUESHMËRINË FISKALE DHE RRITJEN NË SHQIPËRI

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, e 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për huan për zhvillimin e politikës për qëndrueshmërinë fiskale dhe rritjen në Shqipëri, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 8.2.2021.

Shpallur me dekretin nr. 11973, datë 19.2.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

MARRËVESHJE HUAJE
HUAJA PËR ZHVILLIMIN E POLITIKËS PËR QËNDRUESHMËRINË FISKALE DHE RRITJEN NË SHQIPËRI NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

MARRËVESHJE HUAJE

Marrëveshja, data e së cilës është data e Nënshkrimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka), me qëllim ofrimin e financimit në mbështetje të Programit (siç përcaktohet në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje). Banka ka vendosur ta ofrojë këtë financim, ndër të tjera, bazuar në: i. masat e ndërmarra tashmë nga Huamarrësi, në kuadër të Programit, të përshkruara në seksionin IA të skedulit 1 të Marrëveshjes; dhe ii. ruajtjen nga Huamarrësi të një kuadri të përshtatshëm politikash makroekonomike. Si rrjedhojë, Huamarrësi dhe Banka bien dakord si më poshtë:

Neni I
Kushtet e përgjithshme; përkufizime

1.01 Kushtet e Përgjithshme (siç janë përcaktuar në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje) zbatohen dhe janë pjesë e Marrëveshjes.

1.02 Nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, termat që fillojnë me shkronjë të madhe në këtë Marrëveshje kanë kuptimet që u janë dhënë atyre në Kushtet e Përgjithshme ose në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

Neni II
Huaja

2.01 Banka pranon t'i japë hua Huamarrësit shumën prej tetëdhjetë milionë dollarësh ($80.000.000), ndërsa kjo vlerë mund të konvertohet në çdo kohë nëpërmjet Konvertimit të Monedhës (Huaja).

2.02 Tarifa fillestare është sa një e katërta e një për qind (0.25%) të shumës së Huas.

2.03 Tarifa e Angazhimit është sa një e katërta e një për qind (0.25%) në vit e Tepricës së Patërhequr të Huas.

2.04 Norma e interesit është Norma e Referencës plus Marzhi Fiks ose norma që mund të aplikohet pas Konvertimit; objekt i përcaktimeve në seksionin 3.02(e) të Kushteve të Përgjithshme.

2.05 Datat e Pagesës janë 1 maj dhe 1 nëntor të çdo viti.

2.06 Vlera e principalit të kësaj Huaje do të shlyhet në përputhje me skedulin 2 të kësaj Marrëveshjeje.

2.07 Pa u kufizuar nga dispozitat e seksionit 5.05 të Kushteve të Përgjithshme, Huamarrësi do t'i vërë menjëherë Bankës në dispozicion informacionin lidhur me dispozitat e nenit II, siç mund të kërkohet në mënyrë të arsyeshme, herë pas here, nga Banka.

Neni III
Programi

3.01 Huamarrësi deklaron angazhimin e tij për Programin dhe zbatimin e tij. Për këtë qëllim, dhe në vijim të seksionit 5.05 të Kushteve të Përgjithshme:

a) Huamarrësi dhe Banka, me kërkesë të secilës palë, shkëmbejnë herë pas here pikëpamje mbi kuadrin e politikave makroekonomike të Huamarrësit dhe ecurinë e arritur në zbatimin e Programit;

b) Pa u kufizuar nga paragrafi "a" i këtij seksioni, Huamarrësi e informon Bankën menjëherë për çdo situatë që do të sillte ndryshim nga pikëpamja materiale të objektivave të Programit ose çdo veprim të ndërmarrë në kuadër të Programit, përfshirë çdo veprim të specifikuar në seksionin I të skedulit 1 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni IV
Mjetet juridike të Bankës

4.01 Rasti shtesë i pezullimit nënkupton krijimin e një situate, e cila e bën të pamundur realizimin e Programit ose të një pjese të konsiderueshme të tij.

4.02 Rasti Shtesë i Përshpejtimit nënkupton se rasti i specifikuar në seksionin 4.01 të kësaj Marrëveshjeje ka ndodhur dhe vazhdon për një periudhë 30-ditore pas njoftimit që Banka i ka dhënë Huamarrësit.

Neni V
Efektiviteti; zgjidhja

5.01 Kushti Shtesë për Efektivitetin nënkupton se Banka është e kënaqur me ecurinë e arritur nga Huamarrësi në zbatimin e Programit dhe me përshtatshmërinë e kuadrit të politikave makroekonomike të Huamarrësit.

5.02 Afati për Efektivitetin është 90 (nëntëdhjetë) ditë pas Datës së Nënshkrimit.

Neni VI
Përfaqësuesi; adresat

6.01 Përfaqësuesi i Huamarrësit është ministri i Financave dhe Ekonomisë.

6.02 Për qëllimet e specifikuara në seksionin 10.01 të Kushteve të Përgjithshme:

a) adresa e Huamarrësit është:
Ministria e Financave dhe e Ekonomisë
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3
Tiranë, Shqipëri; dhe
b) Adresa elektronike e Huamarrësit është:
Faks: *Email*:
355-4222-8494sekretariamin@financa.gov.al

6.03 Për qëllimet e specifikuara në seksionin 10.01 të Kushteve të Përgjithshme:

a) adresa e Bankës është:
Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
Shtetet e Bashkuara të Amerikës; dhe
b) Adresa elektronike e Bankës është:
Teleks: 248423(MCI) or 64145(MCI)
Faks: 1-202-477-6391
Email: msalim1@worldbank.org
Rënë dakord në datën e nënshkrimit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Nga

Përfaqësuesi i Autorizuar
Emri: Anila Denaj
Titulli: Ministër i Financave dhe Ekonomisë
Data: 7.1.2021

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
Nga

Përfaqësuesi i Autorizuar
Emri: Linda van Gelder
Titulli: Drejtor Rajonal, Ballkani Perëndimor
Data: 21 dhjetor 2020

SKEDULI 1
MASAT E PROGRAMIT;
DISPONUESHMËRIA E TË ARDHURAVE TË HUAS

SEKSIONI I
MASAT NË KUADËR TË PROGRAMIT

A. Masat e marra, në kuadër të Programit. Masat e marra nga Huamarrësi në kuadër të Programit përfshijnë sa më poshtë:

1. Huamarrësi: i. ka nxjerrë një vendim që detyron publikimin periodik të raporteve të shpenzimeve tatimore, siç përcaktohet në urdhrin nr. 389, datë 14.11.2019; si edhe ii. ka botuar dhe publikuar në faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë një raport të shpenzimeve tatimore në dhjetor 2019.

2. Huamarrësi ka miratuar masa për zbatimin sa më efektiv të përputhshmërisë tatimore, të cilat përfshijnë: i. vendimin për riorganizimin strukturor të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT), i cili përcakton krijimin e një njësie të dedikuar për analizën e riskut në Drejtorinë e Shërbimit të Tatimpaguesve të Mëdhenj, siç përcaktohet në urdhrin nr. 86, datë 2.5.2019; dhe ii. vendimin për zgjerimin e kritereve për identifikimin e tatimpaguesve të mëdhenj, siç përcaktohet në rregulloren nr. 8442, datë 4.10.2019.

3. i. Janë miratuar ndryshimet në ligjin e PPP-ve që përcaktojnë kufizime për propozimet e pakërkuara për PPP-të dhe krijimin e kuadrit për monitorimin e tyre; dhe ii. Huamarrësi ka: a) miratuar një udhëzim për zbatimin e kuadrit të monitorimit të PPP-ve, siç përcaktohet në udhëzimin nr. 35 të botuar në Fletoren Zyrtare më 18.12.2019; dhe b) ka nxjerrë raportin e parë të monitorimit të PPP-ve në dhjetor 2019, i cili është publikuar në faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

4. Banka e Shqipërisë ka miratuar një udhëzim për zgjidhje jashtë sistemit gjyqësor për ristrukturimin e kredive me probleme dhe ka zgjeruar efektet e tij deri më 1 janar 2022, siç dëshmohet në vendimin nr. 51 botuar në Fletoren Zyrtare më 24 korrik 2019 dhe në vendimin nr. 34, botuar në Fletoren Zyrtare më 4 qershor 2020.

5. Është miratuar Ligji për Tregjet e Kapitalit, i cili synon forcimin e kuadrit ligjor, rregullator dhe mbikëqyrës për zhvillimin e tregut të kapitalit.

6. Është miratuar Ligji për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive, i cili mundëson përdorimin e një game më të gjerë të fondeve të investimeve në Shqipëri dhe rritjen e shkallës së mbrojtjes së investitorëve.

7. Është miratuar Ligji për Shërbimet e Pagesave, i cili mundëson akses në një gamë më të gjerë të shërbimeve elektronike të pagesave dhe mbrojtje më të madhe të konsumatorit.

8. Qeveria ka miratuar ndryshime në statutin e shoqërisë shtetërore të transmetimit të energjisë (OST), që e lejojnë OST-në të ofrojë shërbime me shumicë nëpërmjet rrjetit të saj të fibrave optike për ofruesit e shërbimit të internetit, me qëllim garantimin e aksesit në internet me shpejtësi të lartë për përdoruesit fundorë, siç evidentohet në procesverbalin nr. CN-427459-12-19, të datës 12 dhjetor 2019.

9. Është miratuar Ligji për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor, i cili synon krijimin e një kuadri ligjor për administrimin e burimeve pyjore në Shqipëri.

SEKSIONI II
DISPONUESHMËRIA E TË ARDHURAVE TË HUAS

A. Të përgjithshme. Huamarrësi mund t'i tërheqë të ardhurat e Huas, në përputhje me dispozitat e këtij seksioni dhe udhëzimet e tjera shtesë të specifikuara nga Banka në njoftimin për Huamarrësin.

B. Alokimi i Shumave të Huas. Huaja (me përjashtim të shumave të kërkuara për të paguar Tarifën Fillestare) jepet në një transh të vetëm tërheqjeje, nga i cili Huamarrësi mund të tërheqë të ardhurat e Huas. Alokimi i shumave të Huas për këtë qëllim jepet në tabelën e mëposhtme:

Alokimet	Shuma e Huas së Alokuar (e shprehur në dollar)
1. Një Transh i Vetëm	79.800.000
2. Tarifa Fillestare	200.000
3. Shuma për t'u paguar në vijim të seksionit 4.05(c) të Kushteve të Përgjithshme	0
SHUMA TOTALE	**80.000.000**

C. Kushtet për Lëshimin e Transhit të Tërheqjes

Tërheqja nga Transhi i Vetëm i Tërheqjes do të kryhet vetëm në rast se Banka është e kënaqur me: a) zbatimin e Programit nga ana e Huamarrësit; dhe b) përshtatshmërinë e kuadrit të politikave makroekonomike të Huamarrësit.

D. Depozitimi i Shumave të Huas

Huamarrësi, brenda 30 (tridhjetë) ditësh pas tërheqjes së Huas nga Llogaria e Huas, duhet t'i raportojë Bankës: a) shumën e saktë të marrë në llogarinë e përmendur në seksionin 2.03(a) të Kushteve të Përgjithshme; b) detajet e llogarisë ku do të kreditohet ekuivalenti në lekë i të ardhurave të huas; c) të dhënat që dëshmojnë se një shumë ekuivalente është kontabilizuar në sistemet e menaxhimit të buxhetit të Huamarrësit; dhe d) deklaratën e faturave dhe disbursimit të llogarisë së përmendur në seksionin 2.03(a) të Kushteve të Përgjithshme.

E. Data e Përfundimit. Data e Përfundimit është 31 dhjetor 2021.

SKEDULI 2
SKEDULI I SHLYERJES SË AMORTIZIMIT TË LIDHUR ME ANGAZHIMIN

Tabela e mëposhtme paraqet Datat e Pagesës së Principalit të Huas dhe përqindjen e vlerës totale të principalit të huas të pagueshme në secilën Datë Pagese të Principalit (Përqindja e Kështit).

Pagesat e Principalit me Këste Fikse

Data e Pagesës së Principalit	Përqindja e Kështit
Në çdo datë 1 maj dhe 1 nëntor Duke filluar më 1 nëntor 2024 Deri më 1 maj 2032	5.88%
Më 1 nëntor 2032	5.92%

SHTOJCË

SEKSIONI I
PËRKUFIZIME

1. "Ndryshimi i Ligjit për PPP-të" është ligji nr. 50/2019 i Huamarrësit, i botuar në Fletoren Zyrtare më 13 shtator 2019.

2. "Ligji për pyjet dhe shërbimin pyjor" është ligji nr. 57/2020 i Huamarrësit, botuar në Fletoren Zyrtare më 28 maj 2020.

3. "DPT" do të thotë Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

4. "Kushte të Përgjithshme" janë "Kushtet e përgjithshme të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e BNRZH-së, Financimi i Politikave për Zhvillim", datë 14 dhjetor 2018.

5. "Ligji për Tregjet e Kapitalit" është ligji nr. 62/2020 i Huamarrësit, botuar në Fletoren Zyrtare më 14 korrik 2020.

6. "Ligji për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive" është ligji nr. 56/2020 i Huamarrësit, botuar në Fletoren Zyrtare më 5 qershor 2020.

7. "DTM" është Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj.

8. "Ligji për Shërbimet e Pagesave" është ligji nr. 55/2020 i Huamarrësit, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 123 në 2 korrik 2020.

9. "Programi" është programi i objektivave, politikave dhe masave të përshkruara ose të përmendura në shkresën e datës 1 shtator 2020 që Huamarrësi i ka drejtuar Bankës, ku deklarohet angazhimi i Huamarrësit për zbatimin e Programit dhe ku kërkohet asistencë nga Banka në mbështetje të Programit gjatë ekzekutimit të tij dhe veprimeve të ndërmarra, përfshirë ato të përshkruara në seksionin I të skedulit 1 të kësaj Marrëveshjeje dhe veprimeve që do të ndërmerren në përputhje me objektivat e programit.

10. "OST" është Operatori i Sistemit të Transmetimit.

11. "Data e Nënshkrimit" është data më e vonë ndërmjet dy datave kur Huamarrësi dhe Banka kanë Nënshkruar këtë Marrëveshje dhe ky përkufizim është i vlefshëm për të gjitha referencat për "datën e Marrëveshjes së Huas" në Kushtet e Përgjithshme.

12. "Transh me një tërheqje të vetme" është vlera e Huas e alokuar për kategorinë e titulluar "Transh me një Tërheqje të Vetme" në tabelën e paraqitur në pjesën B të seksionit II të skedulit 1 të kësaj Marrëveshjeje.

DEKRET
Nr. 11973, datë 19.2.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe të nenit 93, të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 18/2021, "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për huan, për zhvillimin e politikës, për qëndrueshmërinë fiskale dhe rritjen në Shqipëri".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET
Nr. 11974, datë 19.2.2021

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe të nenit 93, të Kushtetutës, si dhe të nenit 23, pika 1, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Nektario Petrika Treska
2. Endlers Isa Kertusha
3. Marsel Klement Nakuçi
4. Ermal Gëzim Guni
5. Olivia Anduena Ermal Guni
6. Danijel Jordan Zllatiçanin
7. Joana Dhimitraq Piperi
8. Armando Shendet Sadiku

9. Afërdita Servet Kanina
10. Marçela Saimir Shtishi
11. Gëzim (Gezim) Manuel Bono
12. Adnand Hasan Pashaj
13. Liman Selman Shaqiri
14. Sabahete Halil Berisha (Ismalaj)
15. Enea Vangjel Liçaj (Licaj)
16. Dionysis Gjergji Shkurti
17. Rahela Havzi Osmani (Drazhi)
18. Erjon Selman Alla
19. Fife Mahmut Bulica
20. Manuel Qemal Brakaj
21. Eraldo Bexhet Stiegler (Skenderasi)
22. Eni Edmond Bilbili

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

URDHËR
Nr. 32, datë 26.1.2021

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES MBI FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES TË CERTIFIKIMIT TË SUBJEKTEVE QË USHTROJNË VEPRIMTARINË E AGROTURIZMIT, PROCEDURAT E APLIKIMIT, TË VLERËSIMIT PARAPRAK DHE PËRFUNDIMTAR, SI DHE PEZULLIMI DHE/OSE SHFUQIZIMI I "CERTIFIKATËS PARAPRAKE" APO I "CERTIFIKATËS"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, dhe të pikës 14, të vendimin nr. 22, datë 12.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kritereve e të procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të tij", i ndryshuar,

URDHËROJMË:

1. Miratimin e rregullores mbi funksionimin e komisionit vlerësues të certifikimit të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e agroturizmit, procedurat e aplikimit, të vlerësimit paraprak dhe përfundimtar, si dhe pezullimi dhe/ose shfuqizimi i "Certifikatës paraprake" apo i "Certifikatës", sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Urdhri i përbashkët nr. 311, datë 9.9.2019, "Për miratimin e rregullores mbi funksionimin e komisionit vlerësues të certifikimit të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e agroturizmit, procedurat e aplikimit, të vlerësimit paraprak dhe përfundimtar, si dhe pezullimi dhe/ose shfuqizimi i "Certifikatës paraprake" apo i "Certifikatës", shfuqizohet.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Komisioni Vlerësues.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Blendi Klosi
MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

Milva Ekonomi
MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL

RREGULLORE
MBI FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES TË CERTIFIKIMIT TË SUBJEKTEVE QË USHTROJNË VEPRIMTARINË E AGROTURIZMIT, PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË VLERËSIMIT PARAPRAK DHE PËRFUNDIMTAR, SI DHE PEZULLIMI DHE/OSE SHFUQIZIMI I "CERTIFIKATËS PARAPRAKE" APO I "CERTIFIKATËS"

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e mënyrës së organizimit dhe të funksionimit të Komisionit Vlerësues të Certifikimit të Subjekteve

(më poshtë "Komisioni"), që ushtrojnë veprimtarinë e agroturizmit, përcaktimin e procedurave të aplikimit dhe të vlerësimit të tyre për subjektet që aplikojnë për marrjen e "Certifikatës paraprake" ose "Certifikatës", detyrat, përgjegjësitë dhe mënyrën e ushtrimit dhe zbatimit të tyre si dhe rastet e pezullimit dhe/ose shfuqizimit të "Certifikatës paraprake" apo "Certifikatës".

Neni 2
Përkufizime

Të gjithë termat e përcaktuara në vendimin nr. 22, datë 12.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kritereve e të procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të tij", të ndryshuar (më poshtë "VKM nr. 22/2018, e ndryshuar") kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë rregullore, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) "Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor" (SHBB) është shoqëria sipas kuptimit të dhënë në ligjin nr. 38/2012, "Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor".

b) "Organizata", janë organizatat sipas kuptimit të dhënë në ligjin nr. 64/2012 "Për peshkimin", të ndryshuar.

c) "Aplikim elektronik" është aplikim nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania*, ku të mundësohet aplikimi për pajisjen me "Certifikatë paraprake" apo "Certifikatë" për ushtrimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ngarkimi i dokumenteve që shoqërojnë aplikimin.

KREU II
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KOMISIONIT

Neni 3
Statusi i Komisionit

1. Komisioni është organ kolegjial, vendimmarrës, i ngritur pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin dhe funksionon sipas kësaj rregullore dhe legjislacionit në fuqi për organet kolegjiale, për aq sa nuk është parashikuar në këtë rregullore.

2. Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave për certifikimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e agroturizmit, për dhënien, pezullimin dhe/ose shfuqizimin e "Certifikatës paraprake" dhe "Certifikatës", sipas kushteve dhe kritereve të certifikimit të veprimtarive të agroturizmit të përcaktuara në VKM-në nr. 22/2018, të ndryshuar.

Neni 4
Përbërja

Komisioni përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë si më poshtë:

a) tre përfaqësues nga ministria përgjegjëse për turizmin;

b) dy përfaqësues nga ministria përgjegjëse për bujqësinë.

Neni 5
Organizimi i Komisionit

1. Komisioni ngrihet me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin. Ministri përgjegjës për bujqësinë, propozon dy përfaqësues për këtë komision dhe kryen funksionet sipas kësaj rregulloreje. Urdhri për ngritjen e Komisionit të certifikimit të subjekteve të agroturizmit përcakton në mënyrë nominale kryetarin dhe anëtarët e Komisionit.

2. Në rast se kryetari mungon ose është në pamundësi për të ushtruar kompetencat, anëtari me i vjetër në detyrë i Komisionit merr dhe ushtron kompetencat për drejtimin e Komisionit.

3. Komisioni, në zbatimin e detyrave dhe përgjegjësive të tij, asistohet nga sekretariati teknik, rolin e të cilit e luan Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Turizmit, pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin.

Neni 6
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

1. Komisioni ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) Merr në shqyrtim të gjitha aplikimet e paraqitura nga subjektet në mënyrë elektronike, në sistemin *e-Albania*, që aplikojnë për t'u pajisur me "Certifikatë paraprake" dhe Certifikatën", të përcjella nëpërmjet sekretariatit teknik;

b) Merr vendim për lëshimin e "Certifikatës paraprake" ose "Certifikatës" ose refuzimin e aplikimit të subjektit për t'u pajisur me këto

certifikata, në rast të mosplotësimit të kritereve të përcaktuara në VKM-në nr. 22/2018, të ndryshuar.

2. Shqyrton të gjitha konstatimet e shkeljeve të paraqitura nga organet përkatëse të përcaktuara në kreun III, pika 18, të VKM-së nr. 22/2018, të ndryshuar. Inspektorati që mbulon fushën e turizmit, informon çdo 6 muaj, Komisionin, nëpërmjet sekretariatit teknik, mbi zbatimin nga subjektet e certifikuara që ushtrojnë veprimtari agroturizmi, të detyrimeve ligjore, në lidhje me procesin e certifikimit dhe problematikat e konstatuara.

Neni 7
Funksionimi i Komisionit

1. Komisioni mblidhet si rregull 1 (një) herë në muaj apo në çdo rast kur ka të paktën 2 (dy) aplikime për shqyrtim. Komisioni mund të mblidhet edhe kur shumica e anëtarëve paraqesin kërkesë me shkrim, duke përcaktuar çështjet për të cilat thirret kjo mbledhje.

2. Mbledhjet e Komisionit asistohen nga Sekretariati Teknik, e cila është përgjegjëse për shpërndarjen e materialeve përkatëse te të gjithë anëtarët e Komisionit.

3. Në qoftë se aplikimi i subjektit për pajisjen me "Certifikatë paraprake" apo "Certifikatë" nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara në VKM-në nr. 22/2018, të ndryshuar, sekretariati teknik, brenda 10 (dhjetë) ditë pune nga data e aplikimit në portalin *e-Albania*, njofton aplikuesin nëpërmjet portalit *e-Albania*, për plotësimin e dokumentacionit ose korrigjimin e pasaktësive dhe i cakton atij një afat prej 14 (katërmbëdhjetë) ditësh kalendarike, për ngarkimin e dokumentacionit përkatës.

4. Sekretariati teknik njofton kryetarin e Komisionit për çdo aplikim të hedhur në portalin *e-Albania* për pajisjen me "Certifikatën paraprake" apo "Certifikatë", si dhe për çdo problematikë të paraqitur nga organet konstatuese. Kryetari i Komisionit vendos për datën, kohën, rendin e ditës dhe vendin e mbledhjeve.

5. Data e mbledhjes u njoftohet anëtarëve të Komisionit, brenda 5 (pesë) ditëve pune, pas paraqitjes së aplikimit, sipas përcaktimit në pikën 1 dhe të paktën 3 (tri) ditë pune përpara datës së caktuar për zhvillimin e saj. Anëtarët e Komisionit njoftohen nga sekretariati teknik, në rrugë elektronike, pa vonesë për çdo ndryshim në datën, kohën dhe vendin e caktuar për mbledhje.

6. Sekretariati teknik përgatit rendin e ditës së bashku me dokumentacionin përkatës dhe në mbledhjen e radhës i vendos në dispozicion të çdo anëtari.

7. Sekretariati teknik mban procesverbalin e mbledhjes, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës. Votat e anëtarëve regjistrohen në procesverbalin e mbledhjes.

Neni 8
Procedura e marrjes së vendimeve

1. Komisioni merr vendim të lëshojë ose jo, sipas rastit, "Certifikatën paraprake" apo "Certifikatën" lidhur me çdo aplikim që është paraqitur nga subjektet e interesuara.

2. Komisioni merr vendim, sipas rastit, të pezullojë dhe/ose të shfuqizojë "Certifikatën paraprake" apo "Certifikatën".

3. Komisioni, brenda 50 (pesëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e aplikimit në portalin *e-Albania* të aplikuesit ose nga data e ngarkimit të dokumentacionit të plotë në portalin *e-Albania*, e shqyrton atë dhe i parashtron brenda 5 (pesë) ditëve pune ministrit përgjegjës për turizmin vendimin e Komisionit për lëshimin ose jo të "Certifikatës paraprake" ose "Certifikatës".

4. Në rast se Komisioni refuzon aplikimin për pajisjen me "Certifikatën paraprake" ose "Certifikatën", vendimi duhet të jetë i arsyetuar dhe i njoftohet subjektit brenda 10 (dhjetë) ditë pune nga vendimmarrja e Komisionit.

5. Në rast se Komisioni, gjatë shqyrtimit të aplikimit dhe dokumentacionit shoqërues, konstaton parregullsi apo lindin dyshime të arsyeshme për të dhënat e deklaruara, si dhe për përmbajtjen e dokumentacionit, sipas rastit ngrihet një grup pune me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin për verifikimin në terren të të dhënave. Komisioni, nëpërmjet sekretariatit teknik, njofton subjektin dhe grupin e verifikimit, si dhe koordinon vizitën në terren.

6. Grupi i punës i paraqet Komisionit raportin përmbledhës të gjetjeve të konstatuara brenda 5 (pesë) ditëve pune nga dita e verifikimit.

7. Ndaj vendimit të komisionit mund të ushtrohet ankim nga marrja dijeni e njoftimit, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

8. Komisioni i zhvillon mbledhjet kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Komisioni i merr vendimet me votim të hapur dhe me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të tij të pranishëm në mbledhje. Në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë, vota e kryetarit është vendimtare.

9. Komisioni mban procesverbal, në të cilën pasqyrohet procedura që ndiqet për shqyrtimin e aplikimit, si dhe vendimmarrja e Komisionit. Procesverbali firmoset nga të gjithë anëtarët e Komisionit të pranishëm në mbledhje. Vendimi i Komisionit, lidhur me çdo aplikim i dërgohet menjëherë ministrit përgjegjës për turizmin.

10. Ministri përgjegjës për turizmin, bazuar në vendimin e Komisionit, lëshon "Certifikatën paraprake" apo "Certifikatën" për çdo subjekt.

Neni 9
Votimi i detyrueshëm

1. Kryetari i Komisionit i fton anëtarët, që janë të pranishëm në mbledhje dhe që nuk kanë pengesë ligjore për të votuar, të votojnë, duke votuar vetë i fundit.

2. Anëtarët e Komisionit që janë të pranishëm në mbledhje dhe që nuk kanë pengesë ligjore për të votuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi, nuk mund të abstenojnë.

Neni 10
Deklarimi i pengesave ligjore

1. Në rastet kur një anëtar i Komisionit është i prekur nga një pengesë ligjore, sipas legjislacionit në fuqi për konfliktin e interesave, ai duhet të lajmërojë menjëherë kryetarin e Komisionit.

2. Kryetari merr vendim për përjashtimin nga votimi të anëtarit të Komisionit, në rast kërkese, sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Kur kërkesa për përjashtimin e një anëtari të Komisionit bëhet jo nga vetë anëtari, por nga një palë e interesuar, kryetari e merr vendimin për përjashtimin ose jo, pas një hetimi të gjithanshëm dhe pasi dëgjon dhe argumentet e anëtarit që dyshohet se ka pengesa ligjore.

4. Në rastet kur vetë kryetari preket ose dyshohet se preket nga një pengesë ligjore, vendimin për përjashtimin ose mospërjashtimin e tij nga votimi e merr vetë Komisioni.

5. Në çdo rast, vendimi për përjashtimin ose jo nga votimi të një anëtari apo të kryetarit të Komisionit merret brenda 5 (pesë) ditëve pune nga dita kur vetë anëtari deklaron pengesën ose kur pala e interesuar bën kërkesën. Në këtë rast, atributet e kryetarit i merr anëtari më i vjetër në detyrë me të drejtë vote.

6. Anëtarët e Komisionit që kanë pengesë ligjore për të votuar nuk duhet të jenë të pranishëm gjatë diskutimeve dhe gjatë votimit.

Neni 11
Konfidencialiteti

Anëtarët e Komisionit duhet të ruajnë sekretin profesional dhe konfidencialitetin e diskutimeve, dokumenteve dhe çdo informacioni që u vihet në dispozicion gjatë zbatimit të procedurave të certifikimit sipas legjislacionit në fuqi.

KREU III
PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË VLERËSIMIT

Neni 12
Kriteret e nevojshme për aplikim

1. Aplikuesit mund të jenë fermerë, grup fermerësh, persona fizikë ose juridikë, shoqëri të bashkëpunimit bujqësor (SHBB), organizatat e peshkimit (OP).

2. Fermerët, duhet të jenë të pajisur me NIPT-in e fermerit.

3. SHBB-të, OP-të dhe personat fizikë dhe juridikë të jenë të pajisur me NIPT/NUIS.

4. Aplikuesi me statusin fermer ose person fizik dhe juridik, që kryen aktivitet për prodhimin bujqësor dhe blegtoral, peshkim/akuakulturë, njësi agrikulturore, në momentin e aplikimit, duhet të plotësojë formularin e aplikimit në portalin *e-Albania*.

Neni 13
Aplikimi

1. Aplikimi për marrjen e "Certifikatës paraprake" apo e "Certifikatës" kryhet nëpërmjet portalit *e-Albania*.

2. Informacioni për mënyrën e aplikimit në portalin *e-Albania*, kriteret e nevojshme për

përfitim, tarifat dhe mënyrën e procedimit deri në përfitimin e "Certifikatës paraprake" apo "Certifikatës" publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë përgjegjëse për turizmin dhe në platformën *e-Albania*.

Neni 14
Dokumentacioni për përfitimin e "Certifikatës paraprake"

1. Me qëllim plotësimin e kritereve të parashikuara në VKM-në nr. 22/2018, të ndryshuar, subjektet që aplikojnë për përfitimin e "Certifikatës paraprake" duhet të plotësojnë dhe ngarkojnë në portalin *e-Albania* formularin e aplikimit për pajisjen me "Certifikatë paraprake për veprimtari pritëse të certifikuar si agroturizëm", si dhe dokumentacionin e mëposhtëm:

a) plan-biznesin e nënshkruar dhe, në rastin e personave juridikë, të vulosur nga aplikuesi apo person i autorizuar prej tij, sipas formularit të aneksit 1 (për një periudhë jo më pak se 7 vjet);

b) mandatpagesën për aplikim në shumën 2000 lekë;

c) certifikatë pronësie e shoqëruar me kartelën e pasurisë, e cila të jetë lëshuar brenda 3 (tre) muajve të fundit nga momenti që subjekti bën aplikimin në portalin *e-Albania* dhe hartën treguese/kontratë tjetër që vërteton marrëdhënien e lidhur për tokën ku do të ndërtohet objekti dhe ferma në funksion të agroturizmit. Certifikata e pronësisë, ku do të ndërtohet objekti duhet të jetë i llojit truall;

d) leja e zhvillimit e lëshuar nga organet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit dhe/ose dokumentet nga bashkia që lejon ndërtimin e strukturës/objektit në funksion të agroturizmit. Leja e zhvillimit për ushtrimin e veprimtarisë së agroturizmit duhet të jetë në përputhje me kriteret e përcaktuara në VKM-në nr. 22/2018, të ndryshuar dhe në këtë rregullore;

e) projekti dhe relacioni arkitektonik, i firmosur dhe vulosur nga administratori i subjektit dhe inxhinieri/studio inxhinierike, që e ka hartuar projektin dhe relacionin, për të gjithë strukturën e agroturizmit që do të ndërtohet, ku të jetë e përfshirë ferma bujqësore/blegtorale/peshkim/akuakulturë ose njësia agrikulturore, akomodimi, ushqimi dhe pijet;

f) grafikun e punimeve, i firmosur dhe i vulosur nga administratori i subjektit dhe inxhinieri/studio inxhinierike, që e ka hartuar projektin dhe relacionin, si edhe nga kompania e ndërtimit që do të realizojë punimet, e cila duhet të jetë në përputhje me vlefshmërinë e "Certifikatës paraprake";

g) Plan-vendosja e objektit dhe e fermës bujqësore/blegtorale/peshkimit/akuakulturës/njësi së agrokulturore, e firmosur dhe e vulosur nga administratori i subjektit dhe inxhinieri/studio inxhinierike, që e ka hartuar projektin dhe relacionin, mbi fragmentin e hartës mbi gjendjen ekzistuese;

h) në rast se subjekti zotëron fermën blegtorale, duhet të dorëzojë vërtetimin nga sistemi i informacionit blegtoral dhe veterinar "RUDA", i cili të jetë i lëshuar brenda 3 (tre) muajve të fundit nga momenti që subjekti bën aplikimin në portalin *e-Albania*;

i) dokumentet e përcaktuara në këtë nen duhet të jenë origjinale ose të njësuara me origjinalin.

Neni 15
Dokumentacioni për përfitimin e "Certifikatës"

1. Krahas dokumentacionit që vërtetojnë plotësimin e kritereve të parashikuara në VKM-në, subjektet duhet të plotësojnë dhe ngarkojnë në portalin *e-Albania* formularin e aplikimit për pajisjen me "Certifikatë, subjekt i certifikuar për veprimtarinë e agroturizmit", si dhe dokumentacionin e mëposhtëm:

2. Dokumentet e nevojshme që duhet të plotësojë subjekti në lidhje me fermën bujqësore/ blegtorale/peshkimit/akuakulturës apo njësinë agrikulturore janë:

a) certifikatë pronësie për fermën/tokën ku zhvillohet veprimtaria që do të certifikohet ose kontratë për marrjen e saj me qira ose kontratë përdorimi për një periudhë jo më pak se 5 (pesë) vjet (kopje të njësuara me origjinalin). Certifikata e pronësisë duhet të shoqërohet me kartelën e pasurisë, e cila të jetë lëshuar brenda 3 (tre) muajve të fundit nga momenti që subjekti bën aplikimin në portalin *e-Albania* dhe hartën treguese;

b) plan-biznesin, të firmosur dhe vulosur nga administratori i subjektit, sipas formularit të aneksit nr. 1 (për një periudhë jo më pak se 5 (pesë) vjet);

c) në rast se subjekti zotëron fermën blegtorale, duhet të dorëzojë vërtetimin nga sistemi i

informacionit blegtoral dhe veterinar "RUDA", i cili të jetë i lëshuar brenda 3 (tre) muajve të fundit nga momenti që subjekti bën aplikimin në portalin *e-Albania*;

d) mandatpagesën për aplikim në shumën 2000 lekë.

3. Dokumentet e nevojshme që duhet të plotësojë subjekti, në lidhje me shërbimin e akomodimit:

a) certifikatë pronësie/kontratë qiraje/kontratë përdorimi për objektin, të lidhur midis subjekteve me një afat jo më pak se 5 (pesë) vjet (kopje të njësuara me origjinalin). Certifikata e pronësisë duhet të shoqërohet me kartelën e pasurisë, e cila të jetë lëshuar brenda 3 (tre) muajve të fundit nga momenti që subjekti bën aplikimin në portalin *e-Albania* dhe hartën treguese;

a) planimetria e çdo kati për strukturën akomoduese e firmosur dhe e vulosur nga administratori i subjektit dhe inxhinieri/studio inxhinierike, që e ka hartuar projektin dhe relacionin, ku të jenë të identifikuara qartë numri i dhomave, në të cilat të përfshihet edhe plani i mobilimit;

b) plan-vendosja e objektit, të firmosur dhe vulosur nga administratori i subjektit dhe inxhinieri/studio inxhinierike, që e ka hartuar projektin dhe relacionin ose harta treguese e pasurisë;

c) fotografi të jashtme të strukturës akomoduese dhe të brendshme të dhomave.

d) vetëdeklarimin në portalin *e-Albania* për plotësimin e kushteve të bujtinës, sipas standardeve të përcaktuara në aneksin 1/a, të VKM-së nr. 730, datë 20.10.2016, "Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese", të ndryshuar, si dhe çdo dokument tjetër, të lëshuar nga organet kompetente për kategorizimin e strukturave akomoduese. Në rastet kur Komisioni ka paqartësi, në lidhje me plotësimin e kushteve për strukturën/objektin akomodues, mund të ndërmerret nga ana e tij procedura e verifikimit në terren.

4. Dokumentet e nevojshme, që duhet të plotësojë subjekti në lidhje me shërbimin "ushqim dhe pije":

a) certifikatë pronësie/kontratë qiraje/kontratë përdorimi për objektin, të lidhur midis subjekteve me një afat jo më pak se 5 (pesë) vjet, në rast se objekti "ushqim dhe pije" është i ndarë nga struktura akomoduese (kopje të njësuara me origjinalin). Certifikata e pronësisë duhet të shoqërohet me kartelën e pasurisë, e cila të jetë lëshuar brenda 3 (tre) muajve të fundit nga momenti që subjekti bën aplikimin në portalin *e-Albania* dhe hartën treguese;

b) fotografi të jashtme dhe të brendshme të restorantit;

c) vetëdeklarimin në portalin *e-Albania* që mban përgjegjësi që minimalisht 30% e produkteve ushqimore dhe të pijeve të jenë me origjinë nga ferma, jo më pak se 40% të sasisë së tyre, me origjinë lokale, brenda territorit të bashkisë ku ushtrohet veprimtaria e agroturizmit dhe jo më shumë se 30% e sasisë së tyre me origjinë tjetër;

5. Dokumentet e nevojshme që duhet të plotësojë subjekti për shërbimin "veprimtari argëtuese/çlodhëse, të lidhura me fermën ose mjedisin përreth":

a) subjekti duhet të plotësojë në portalin *e-Albania* llojin e veprimtarive që do të ofrohen, ku të paraqiten itineraret me shpjegimet përkatëse për çdo aktivitet. Të ngarkohet në portalin *e-Albania* edhe dokumenti justifikues (p.sh.: marrëveshjen me udhërrëfyesin turistik, certifikatën e udhërrëfyesit turistik të lëshuar nga ministria përgjegjëse për turizmin etj.).

6. Dokumentet e nevojshme që duhet të plotësojë subjekti, që duhet të ofrojë edhe shërbimin e akomodimit kamping:

a) certifikatë pronësie/kontratë qiraje/kontratë përdorimi për sipërfaqen ku do të vendosen makinat e fushimit, me sipërfaqe jo më shumë se 1000 m², shoqëruar me hartën treguese dhe planimetrinë/planin e vendosjes së makinave të fushimit, të lidhur midis subjekteve me një afat jo më pak se 5 (pesë) vjet (kopje të njësuara me origjinalin). Certifikata e pronësisë duhet të shoqërohet me kartelën e pasurisë, e cila të jetë lëshuar brenda 3 (tre) muajve të fundit nga momenti që subjekti bën aplikimin në portalin *e-Albania* dhe hartën treguese;

b) vetëdeklarimin në portalin *e-Albania* për plotësimin e kushteve të kampingut, sipas standardeve të përcaktuara në aneksin 1/c, të VKM-së nr. 730, datë 20.10.2016, "Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese", të ndryshuar, si dhe çdo dokument

tjetër, të lëshuar nga organet kompetente për kategorizimin e strukturave akomoduese. Në rastet kur Komisioni ka paqartësi, në lidhje me plotësimin e kushteve të arredimit, mund të ndërmerret nga ana e tij procedura e verifikimit në terren.

Neni 16
Vlerësimi dhe pajisja me certifikatë

1. Brenda 50 (pesëdhjetë) ditëve kalendarike nga depozitimi i aplikimit në portalin *e-Albania* ose nga data e ngarkimit të dokumentacionit të plotë në portalin *e-Albania*, Komisioni merr në shqyrtim dosjen e aplikantit dhe nënshkruan procesverbalin e vlerësimit për marrjen ose jo të certifikatës.

2. Procesverbali hartohet nga sekretariati teknik dhe nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit.

3. Vendimi për pranimin ose refuzimin e aplikimit për pajisjen me certifikatë paraprake apo certifikatë bëhet mbi bazën e dokumenteve të ngarkuara në portalin *e-Albania* edhe rast pas rasti kur gjykohet e nevojshme nga verifikimi në terren.

4. Mungesa e njërit prej dokumenteve të kërkuara, pas plotësimit të afatit kohor të specifikuar pikën 3, të nenit 7, të kësaj rregulloreje, çon në refuzimin e aplikimit.

5. Njoftimi i subjektit për tërheqjen e "Certifikatës paraprake" ose "Certifikatës" apo refuzimi i kërkesës për pajisje me certifikatë bëhet nëpërmjet portalit *e-Albania*, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e lëshimit të certifikatës apo e vendimit përfundimtar të refuzimit.

6. Marrja/tërheqja e certifikatës paraprake ose e certifikatës bëhet pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin, nga vetë aplikuesi.

Neni 17
Pezullimi

1. Komisioni pezullon "Certifikatën paraprake" apo "Certifikatën" kur konstaton, kryesisht nga verifikimet e kryera prej tij apo nga organet përkatëse të bashkive, të inspektoratit të turizmit, organet tatimore apo organet kompetente të inspektimit të ushqimit dhe kushteve higjieno-sanitare, ndryshim, mospërmbushje ose shkelje të një ose disa kritereve dhe kushteve të përcaktuara në VKM-në nr. 22/2018, të ndryshuar dhe në këtë rregullore.

2. Komisioni, brenda 5 (pesë) ditë pune, nga dita e konstatimit të ndryshimit, mospërmbushjes apo shkeljes së një ose disa kritereve dhe kushteve të përcaktuara në VKM-në nr. 22/2018, të ndryshuar dhe në këtë rregullore, njofton subjektin mbi fillimin e procedurës së pezullimit të "Certifikatës paraprake" apo "Certifikatës". Subjekti brenda 10 (dhjetë) ditë pune, paraqet pranë Komisionit argumente/prova/dokumentacionin e nevojshëm për plotësimin e kritereve dhe/ose kushteve përkatëse.

3. Mosplotësimi i kritereve/i kushteve, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, përbën shkak për shfuqizimin e "Certifikatës paraprake" apo sipas rastit të "Certifikatës".

4. Subjekti, të cilit i pezullohet "Certifikata paraprake" apo "Certifikata" nuk mund ta përdorë atë në ambientet e tij ose në emërtimin tregtar.

5. Vendimi i Komisionit për pezullimin e "Certifikatës paraprake" apo, sipas rastit, të "Certifikatës", duhet të jetë i arsyetuar.

6. Në rast se shkaqet e pezullimit kanë rënë, Komisioni njofton pa vonesë subjektin.

7. Kundër vendimit të Komisionit për pezullimin e "Certifikatës paraprake" apo, sipas rastit, të "Certifikatës, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Neni 18
Shfuqizimi

1. Komisioni nga verifikimet e kryera nga ana e tij, kryesisht apo nga shkeljet e konstatuara nga organet përkatëse, pasi të ketë ezauruar procedurën që garanton të drejtën për t'u informuar, për të kërkuar sqarime rreth fakteve dhe për t'u dëgjuar, mund të shfuqizojë "Certifikatën paraprake" apo "Certifikatën", në rastin kur:

a) konstatohen të dhëna të rreme në dokumentet e aplikimit në platformën *e-Albania* për përfitimin e "Certifikatës paraprake" apo "Certifikatës".

b) nuk përmbushen brenda afatit shkaqet e pezullimit sipas përcaktimit të nenit 17.

c) subjekti shkel në mënyrë të përsëritur një ose disa prej kritereve dhe kushteve të përcaktuara në VKM-në nr. 22/2018, të ndryshuar dhe në këtë rregullore.

2. Shfuqizimi i "Certifikatës paraprake" ose i "Certifikatës" detyron subjektin të kthejë lehtësirat

fiskale të përfituara, sipas parashikimit në pikën 18/1, në VKM-në nr. 22/2018, të ndryshuar.

3. Komisioni, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga marrja e vendimit, i propozon ministrit përgjegjës për turizmin nxjerrjen e aktit të shfuqizimit të "Certifikatës paraprake" apo "Certifikatës".

4. Sekretariati teknik, brenda 3 (tri) ditëve pune nga nxjerrja e aktit, sipas pikës 2 të këtij neni, njofton subjektin.

5. Ndaj vendimit për shfuqizimin e "Certifikatës paraprake" apo "Certifikatës", mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Neni 19
Procesi i monitorimit

1. Monitorimi i të gjithë përfituesve të "Certifikatës paraprake" apo "Certifikatës" bëhet nga ana e organeve përkatëse të bashkive, inspektoratit të turizmit ose organeve kompetente të inspektimit të ushqimit dhe të kushteve higjieno-sanitare, agjencive rajonale të ekstensionit bujqësor, agjencive të shërbimit veteriner dhe mbrojtjes së bimëve, sipas fushës së përgjegjësisë dhe në përputhje me VKM-në nr. 22/2018, të ndryshuar.

2. Në rast konstatimi të shkeljeve, organet e përmendura në pikën 1 të këtij neni njoftojnë Komisionin, nëpërmjet sekretariatit teknik, duke i vënë në dispozicion kopje të firmosura dhe vulosura të akteve të inspektimit.

Neni 20
Vlefshmëria

1. "Certifikata paraprake" është e vlefshme për një periudhë 2-vjeçare (dyvjeçare). Certifikata është e vlefshme për një periudhë 5-vjeçare (pesëvjeçare).

2. Pas plotësimit të afatit kohor të "Certifikatës paraprake" subjektet duhet të kryejnë aplikimin në platformën *e-Albania* për pajisjen më Certifikatën. Certifikata paraprake lëshohet vetëm njëherë, pa të drejtë rinovimi.

3. Subjektet që zotërojnë "Certifikatë paraprake" mund të aplikojnë në platformën *e-Albania* për "Certifikatë" edhe para përfundimit të afatit 2-vjeçar (dyvjeçar).

4. Pas plotësimit të afatit kohor të "Certifikatës", subjektet duhet të aplikojnë përsëri për rinovimin e saj në platformën *e-Albania.*

ANEKS 1
PLANI I BIZNESIT

1. Historiku i aktivitetit që aplikon PËR CERTIFIKIM

1.1 Aktiviteti aktual i aplikantit për t'u certifikuar si agroturizëm

- Përshkruani aktivitetin ekzistues që realizohet në fermën/subjektin/baxhon/linjën e përpunimit/bujtinën tuaj etj.

- Përshkruani shërbimet që ofron ferma/ subjekti/baxhoja/linja e përpunimit/bujtina etj., duke specifikuar llojet e shërbimeve akomoduese/ argëtuese/çlodhëse dhe kapacitetet që disponon për secilin nga shërbimet e ofruara në të.

- Përshkruani tregun e shërbimit/produktit tuaj, si dhe konsumatorët tuaj kryesorë.

- Përshkruani kontratat ekzistuese me blerësit, furnizuesit e mallrave.

- Përshkruani shkurtimisht vëllimin ekzistues të shitjeve/shërbimeve dhe çmimet mesatare të marra.

- Përshkruani konkurrentët dhe pozicionin tuaj në tregun lokal.

1.2 Struktura e pronësisë

- Shpjegoni dhe paraqisni një listë të individëve/shoqërive, që kanë lidhje pronësie apo marrëdhënie të tjera që lidhen me çështjet e pronësisë me aktivitetin/biznesin tuaj, të cilat janë të lidhura ngushtë me funksionimin e aktivitetit tuaj ekzistues (nëse ka).

1.3 Përshkrimi i pasurive që zotëron aktiviteti

- Përshkruani dhe paraqisni pasuritë që dispononi:

- tokë (ha);
- serra (ha);
- stalla (m^2);
- numri dhe lloji i kafshëve në fermë;
- banesë e pronarit të fermës (m^2);
- magazina (m^2);
- linja përpunimi (lloji dhe numri);
- makineri dhe pajisje (lloji dhe numri);
- bujtina akomodimi (sip. m^2); kapaciteti në tavolina (numër);
- dhoma akomodimi (numër), shtretër (numër);
- sipërfaqe fushimi (m^2) dhe kapacitet makinash fushimi (nr.).

1.4. Burimet njerëzore

- Numri total i të punësuarve me kohë të plotë, si dhe numri i të punësuarve me kohë të pjesshme dhe sezonale dhe

sa prej tyre jetojnë në fshatin/komunën/bashkinë ku zhvillohet aktiviteti juaj.

- Përshkruani strukturën e drejtimit të aktivitetit/biznesit.

1.5 Performanca e aktivitetit për tri vitet e fundit, si dhe perspektiva e së ardhmes për biznesin në fjalë

- Jepni përshkrime të nivelit të performancës financiare të kohëve të fundit.

- Për bizneset e regjistruara në organet tatimore, analizoni shkurtimisht informacionin e bilancit dhe të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve për tri vitet e fundit, që janë dorëzuar së bashku me formularin e aplikimit.

- Në rast se biznesi/shoqëria nuk ka të dhëna të historikut financiar për të paraqitur për tri vitet e fundit, atëherë ajo duhet të paraqesë çdo informacion të disponueshëm mbi veprimtaritë e biznesit (p.sh., të vitit të kaluar).

- Në rast se aplikuesi nuk është i regjistruar pranë autoriteteve tatimore (në përputhje me legjislacionin në fuqi), ai mund ta lërë bosh këtë seksion.

Me respekt,

_____

(emër, mbiemër, firmë, vulë)

URDHËR
Nr. 91, datë 17.2.2021

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN "MBI PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE KËRKESAVE PËR CERTIFIKIMIN VETERINAR TË DISA LLOJEVE KAFSHËSH DHE MISHIT TË FRESKËT TË TYRE, TË CILAT HYJNË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË NGA SHTETE TË CAKTUARA, SI DHE NGA TERRITORE TË TJERA, NË ADMINISTRIM TË KËTYRE SHTETEVE", TË MIRATUAR ME URDHËR NR. 328, DATË 22.11.2011, TË MINISTRIT TË BUJQËSISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 42 dhe në nenin 55, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Certifikata, modeli BOV-X dhe BOV-Y, sipas pjesës së 2-të të urdhrit nr. 328, datë 22.11.2011, për miratimin e rregullores "Mbi përcaktimin e kritereve dhe kërkesave për certifikimin veterinar të disa llojeve kafshësh dhe mishit të freskët të tyre, të cilat hyjnë në Republikën e Shqipërisë nga shtete të caktuara, si dhe nga territore të tjera, në administrim të këtyre shteteve", ndryshohet sipas modelit të certifikatave bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Shfuqizimin e urdhrit nr. 108, datë 28.2.2020, "Për disa ndryshime në rregulloren 'Mbi përcaktimin e kritereve dhe kërkesave për certifikimin veterinar të disa llojeve kafshësh dhe mishit të freskët të tyre, të cilat hyjnë në Republikën e Shqipërisë nga shtete të caktuara, si dhe nga territore të tjera, në administrim të këtyre shteteve', e miratuar me urdhrin nr. 328, datë 22.11.2011, të ministrit të Bujqësisë".

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Milva Ekonomi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTRY OF AGRICULTURE AND RURAL DEVELOPMENT

Çertifikata shëndetësore për importin në Republikën e Shqipërisë të kafshëve të llojit gjedh për mbarështim dhe/ose prodhim

Health veterinary certificate for import of bovine animals for breeding and production

Modeli BOV-X / Model BOV-X

Part I : Details of consignment / Pjesa I :Detajet e dërgesës

I.1. Consignor
Derguesi
Name
Emri
Address
Adresa
Tel. No
Nr. Tel.

I.2. Certificate reference number
Numri i references se Çertifikates

I.2a.

I.3.Central Competent Authority
Autoriteti Kompetent Qendror

I.4. Local Competent Authority
Autoriteti Kompetent Lokal

I.5. Consignee
Marresi
Name
Emri
Address
Adresa
Postal code
Kodi postar
Tel. No
Nr. Tel.

1.6

1.7.Country of origin Shteti i origjines	**ISO code** /kodi	**I.8. Region of origin, Code** Rajoni i origjines, Kodi	**I.9. Country of destination** Shteti i destinacionit	**ISO code** ISO kodi	**I.10. Region of destination** Rajoni i destinacionit	**Code** Kodi

I.11. Place of origin/ Vendi I origjines
Name Emri
Approval number Numri i Aprovimit
Address Adresa

I.12.

Place of loading
Vendi i ngarkeses
Address Adresa
Approval number Numri i Aprovimit

I.14. Date of departure
Data e nisjes

I.15. Means of transport
Mjeti i transportit
Aeroplane / **Aeroplan** ☐ **Ship** / Anije ☐ **Railway wagon** / Hekurudhe ☐
Road vehicle / Automjet ☐ **Other** / Tjeter ☐
Identification :
Identifikimi
Documentary reference :
Dokumenti i referimit

I.16.Entry BIP in Albania
PKK e hyrjes ne Shqiperi

I.17.

I.18. Description of commodity
Pershkrimi i mallit/artikullit

I.19. Commodity code (HS code) 01.02
Kodi i mallit/artikullit (kodi HS) 01.02

I.20. Quantity
Sasia

I.21.

I.22. Number of packages
Numri i pakove

I.23. Seal/ container No
Numri i vules/ kontenierit

I.24.

I.25. Commodity certified for :
Mall i çertifikuar për:
Breeding / Per mbarshtim ☐ **Fattening** / Majmeri ☐

I.26.

I.27. For import or admission into Albania
Per import apo dergim ne Shqiperi ☐

I.28. Identification of the commodity
Identifikimi I mallit

Species (scientific name) Speciet (emri shkencor)	**Breed** Raca	**Identification system** Sistemi i identifikimit	**Identification number** Numri identifikimit	**Age** Mosha	**Sex** Seksi

Part II : Certification / Pjesa II : Çertifikata

II. Health information Informacion shendetsor	II.a. Certificate reference number Çertifikate me numer reference	II.b.

II.1. Public Health attestation
Vertetim per shendetin publik

I, the undersigned official veterinarian, hereby certify, that the animals described in this certificate:
Une i nenshkruari Veterineri Zyrtar, çertifikoj qe kafshet e pershkruara ne kete çertifikate:

II.1.1 come from holdings which have been free from any official prohibition on health grounds, for the past 42 days in the case of brucellosis, for the past 30 days in the case of anthrax and for the past six months in the case of rabies, and, have not been in contact with animals from holdings which did not satisfy these conditions;
Vijne nga ferma qe ka qene jashte çdo bllokimi zyrtar per motive shendetesore ne 42 ditet e fundit per brucelozen, ne 30 ditet e fundit per plasjen dhe 6 muajt e fundit per terbimin, dhe, nuk kane qene ne kontakt me kafshe te fermave te tjera qe nuk kane po te njejtat kushte

II.1.2. have not received:
Nuk kane marre:

- **any stilbene or thyrostatic substances,**
  Ndonje stilbene apo substanca tireostatike,

- **oestrogenic, androgenic, gestagenic or β- agonist substances for purposes other than therapeutic or zoo-technic treatment (as defined in Council Directive 96/22/EC);**
  Estrogjene, androgjene, gestagjene ose substanca β-agoniste per qellime te ndryshme nga ato terapeutike apo trajtime zooteknike (percaktuar ne Direktiven e Keshillit 96/22/EC)

II.1.3. with regard to bovine spongiform encephalopathy (BSE):
Persa i perket encephalopatise spongiforme te gjedhit (BSE):

(a) the animals are identified by a permanent identification system enabling them to be traced back to the dam and herd of origin and they have not been exposed in the following animals:
kafshët jane identifikuar me nje sistem identifikimi permanent qe lejon te gjurmohen ne femrat dhe tufen e origjines, dhe nuk janë ekspozuar ndaj kafshëve të mëposhtme:

(i) any BSE cases
ndonje rast BSE-je

(ii) bovine animals which, during their first year of life, were reared with BSE cases during their first year of life, and which investigation has shown consumed the same potentially contaminated feed during that period, or
kafshët e llojit gjedh të cilët, gjatë vitit të tyre të parë të jetës janë rritur në prani të rasteve të BSE-së dhe në të cilët hetimet tregojnë që kanë konsumuar të njëjtin ushqim potencialisht të kontaminuar gjatë asaj periudhe, ose

(iii) if the result of the investigation refered to in indent (ii) are inconclusive, bovine animals born in the same herd as, and within 12 months of the birth of, the BSE cases;
nëse rezultatet e hetimit të përmendura në paragrafin (ii) janë pa përfundim, kafshët e llojit gjedh të lindura në të njëjtën tufë dhe brenda 12 muajve nga lindja me praninë e rasteve të BSE ;

([1])([2]) **either [(b) if there have been BSE indigenous cases in the country concerned, the animals were born after the date from which the ban on the feeding of ruminants with meat-an-bone meal and greaves derived from ruminants as defined in the Terrestrial Animal Health Code of the World Organisation for Animal Health, was effectively enforced or after the date of birth of the last BSE indigenous cases if born after the date of the feed ban.]**
[Në qoftë se ka pasur raste indigjene me BSE ne vendin e interesuar, kafshët kanë lindur pas datës nga e cila ndalimi i të ushqyerit të ruminanteve me miell mishi-kockash dhe yndyrna qe rrjedhin nga ruminantet siç përcaktohet në Kodin e Shëndetit të Kafshëve Tokësore të Organizatës Botërore për Shëndetin e Kafshëve eshte aplikuar efektivisht, ose pas datës së lindjes nga rastet e fundit indigjene me BSE, ne rastet kur ato kane lindur pas dates se ndalimit te te ushqyerit.]

([1])([3]) **or [(b) the animals were born after the date from which the ban on the feeding of ruminants with meat-an-bone meal and greaves derived from ruminants as defined in the Terrestrial Animal Health Code of the World Organisation for Animal Health, was effectively enforced or after the date of birth of the last BSE indigenous cases if born after the date of the feed ban.]**
[kafshët që kanë lindur pas datës nga e cila ndalimi i të ushqyerit të ruminanteve me miell mishi-kockash dhe yndyrna qe rrjedhin nga ruminantet siç përcaktohet në Kodin e Shëndetit të Kafshëve Tokësore të Organizatës Botërore për Shëndetin e Kafshëve eshte aplikuar efektivisht, ose pas datës së lindjes nga rastet e fundit indigjene me BSE ne rastet kur ato kane lindur pas dates se ndalimit te te ushqyerit.]

([1])([4]) **or [(b) the animals were born at least two years after the date from which the ban on the feeding of ruminants with meat-an-bone meal and greaves derived from ruminants as defined in the Terrestrial Animal Health Code of the World Organisation for Animal Health , was effectively enforced or after the date of birth of the last BSE indigenous cases if born after the date of the feed ban.]**
[kafshët që kanë lindur ne dy vitet e fundit pas datës nga e cila ndalimi i të ushqyerit të ruminanteve me miell mishi-kockash dhe yndyrna qe rrjedhin nga ruminantet siç përcaktohet në Kodin e Shëndetit të Kafshëve Tokësore të Organizatës Botërore për Shëndetin e Kafshëve eshte aplikuar efektivisht, ose pas datës së lindjes nga rastet e fundit indigjene me BSE ne rastet kur ato kane lindur pas dates se ndalimit te te ushqyerit.]

Modeli BOV-X *Çertifikata shëndetësore për importin në Republikën e Shqipërisë të kafshëve të llojit gjedh për mbarështim dhe/ose prodhim*

II.2. Animal Health attestation:
Vertetim per shendetin e kafsheve

I, the undersigned official veterinarian, hereby certify, that the animals described above meet the following requirements:
Une i nenshkruari Veterineri Zyrtar, çertifikoj qe kafshet e pershkruara plotesojne kerkesat e meposhtme:

II.2.1. they come from the territory with code: ..... ([5]) which, at the date of issuing this certificate :
vijne nga territori me kodin : .....([5]) qe, ne daten e leshimit te kesaj çertifikate:

([1]) either [(a) has been free for 24 months from foot-and-mouth disease
ose ka qene e lire per 24 muaj nga afta epizotike,

([1]) or [(a) has been considered free from foot-and-mouth disease since ..... (dd/mm/yyyy), without having had cases/outbreaks after that date, and authorised to export these animals by Commission Implementing Regulation (EU) No ...../ ....., of..... (dd/mm/yyyy),
dhe eshte konsideruar e lire nga semundja e aftes epizotike qe nga ..... (dd/mm/vvvv), dhe nuk ka pasur raste/vatra pas kesaj date, dhe eshte autorizuar per eksportin e ketyre kafsheve nga Rregullorja implementese e Komisionit (EU) Nr ..../....., dt..... (dd/mm/vvvv),]

(b) has been free for 12 months from rinderpest, Rift valley fever, contagious bovine pleuropneumonia and lumpy skin disease and for 6 months from vesicular stomatitis,
kanë qene e lire per 12 muaj nga murtaja e gjedhit, ethja lugines Rift, pleuropnemonia infektive e gjedhit, dermatoza nodulare, dhe per 6 muaj nga stomatiti vezikular,

(c) where during the last 12 months, no vaccination against the diseases mentioned in points (a),(b) and epizootic hemorrhagic disease has been carried out and imports of domestic cloven-hoofed animals vaccinated against these diseases are not permitted;
ku gjate 12 muajve te fundit, nuk jane kryer vaksinime kunder semundjeve të përmendura në pikat (a), (b) dhe kundër sëmundjes hemorragjike epizootike dhe nuk eshte lejuar importi i kafsheve dythundrake te vaksinuar kunder ketyre semundjeve;

([1]) either [(d) has been free for 24 months from bluetongue and 12 months for epizootic haemorrrhagic desease;
[ka qenë e lirë për 24 muaj nga sëmundja e gjuhës blu dhe 12 muaj nga sëmundja hemorragjike epizotike;]

([1]) ([9]) or [(d) has been free for 24 months from bluetongue, and the animals have reacted negatively to a serological test for the detection of the antibody for bluetongue and epizootic haemorrhagic disease, carried out on two occasions on samples of blood taken at the beginning of the isolation/quarantine period and the least 28 days later, on.....(dd/mm/yyyy) and on .....(dd/mm/yyyy), the second of wich must have been taken within 10 days before export;]

kanë qenë të lirë për 24 muaj nga gjuha e blu dhe kafshët kanë reaguar negativisht ndaj një testi serologjik për zbulimin e antitrupave për gjuhën blu dhe për sëmundjen hemorragjike epizootike, të kryer në dy raste në mostrat e gjakut të marra në fillim të periudhës së izolimit / karantinës dhe të paktën 28 ditë më vonë, më ..... (dd / mm / vvvv) dhe më .... (dd / mm / vvv), e dyta e së cilës duhet të jetë marrë brenda 10 ditë para eksportit;]

([1]) or **[(d) has been free for 12 months from epizootic haemorrhagic disease and has not been free for 24 months from bluetongue, and the animals have been vaccinated with an inactivated vaccine, at least 60 days before the date of dispatch to the Republic of Albania, against all bluetongue serotype/s.....(insert serotype/s) which are those present in the source population as demonstrated through a surveillance programme ([12]) in an area with a 150 km radius around the holding(s) of origin described under box reference I. 11., and the animals are still within the immunity period of time guaranteed in the specifications of the vaccine;]**
[(d) kanë qenë të lirë për 12 muaj nga sëmundja hemorragjike epizootike dhe nuk kanë qenë të lirë për 24 muaj nga sëmundja e gjuhës blu dhe kafshët janë vaksinuar me një vaksinë të inaktivuar, të paktën 60 ditë para datës së dërgimit në Republikën e Shqipërisë, kundër të gjithë serotipit/ve të gjuhës blu ..... (vendosni serotipin/et) të cilët janë të pranishëm në popullatë siç tregohet përmes një programi survejance ([12]) në një zonë me një rreze 150 km rreth fermës (ve) së origjinës të përshkruar në kutinë referencë I. 11., dhe kafshët janë ende brenda periudhës së imunitetit, në kohën e garantuar në specifikimet e vaksinës;]

([1]) ([13]) or [(d) is seasonally free of bluetongue and epizootic haemorrhagic disease and the animals have been kept during the seasonally free period in the seasonally free territory since birth or for at least 60 days prior the shipment;]
[është sezonalisht i lirë nga gjuha blu dhe sëmundja hemorragjike epizootike dhe kafshët janë mbajtur gjatë periudhës sezonale të lirë në një territor të lirë sezonal që nga lindja ose për të paktën 60 ditë para dërgesës;]

([1]) ([13]) or [(d) is seasonally free of bluetongue and epizootic haemorrhagic disease and the animals have been kept during the seasonally free period in the seasonally free territory for at least 28 days prior to shipment, and have reacted negatively to a serological test according to the OIE Manual for detection of antibodies for bluetongue and epizootic haemorrhagic disease, carried out al least 28 days after the start of the residence period;]
[është sezonalisht e lirë nga gjuha blu dhe sëmundja hemorragjike epizootike dhe kafshët janë mbajtur gjatë periudhës sezonale të lirë në një territor të lirë sezonal për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe kanë reaguar negativisht ndaj një testi serologjik sipas Manualit të OIE për zbulimin e antitrupave për gjuhën blu dhe sëmundjen hemorragjike epizotike, të kryer të paktën 28 ditë pas fillimit të periudhës së qëndrimit;]

([1]) ([13]) or [(d) is seasonally free of bluetongue and epizootic haemorrhagic disease and the animals have been kept during the seasonally free period in the seasonally free territory for at least 14 days prior to shipment, and have reacted negatively to PCR test for bluetongue virus and epizootic haemorrhagic disease virus according to the OIE Manual, carried out al least 14 days after the start of the residence period;]
[është sezonalisht e lirë nga gjuha blu dhe sëmundja hemorragjike epizootike dhe kafshët janë mbajtur gjatë periudhës sezonale të lirë në një territor të lirë sezonal për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe kanë reaguar negativisht ndaj një testi PCR për virusin e gjuhës blu dhe virusin e sëmundjes hemorragjike epizotike sipas Manualit të OIE, të kryer të paktën 14 ditë pas fillimit të periudhës së qëndrimit;]

II.2.2. they have remained in the territory described under point II.2.1. since birth, or for at least the last six months before dispatch to Albania and without contact with imported cloven-hoofed animals for the last 30 days;
ato kane qendruar ne territorin e pershkruar sipas pikes II.2.1. qe nga lindja, ose te pakten per 6 muajt e fundit perpara dergimit drejt Shqiperise dhe pa pasur kontakt me dy-thundrake te tjere te importuar per 30 ditet e fundit

II.2.3. they have remained since birth or at least 40 days before dispatch in the holding(s) of origin described under point I.11:
ato kane qendruar qe nga lindja ose te pakten per 40 ditet e fundit perpara dergimit ne fermat e origjines pershkruar sipas pikes I.11:

(a) in and around which, in an area with a 150 km radius, there has been no case/outbreak of epizootic haemorrhagic disease during the previous 60 days, and
brenda dhe rreth saj, ne nje zone me rreze 150 km. nuk ka patur asnje rast / shpërthim te hemorragjise infektive epizotike gjate 60 diteve te fundit, dhe

(b) in and around which, in an area with a 10 km radius, there has been no case/outbreak of the foot-and-mouth disease, rinderpest, Rift valley fever, bluetongue, contagious bovine pleuropneumonia, lumpy skin disease and, vesicular stomatitis during the previous 40 days;
brenda dhe rreth saj, ne nje zone me rreze 10 km. nuk ka patur asnje rast / shperthim te sëmundjes së aftës epizotike, murtajës së gjedhit, ethes së luginës Rift, gjuhës blu, pleuropneumonisë infektive të gjedhit, dermatozës nodulare dhe stomatitit vesikular gjate 40 diteve te fundit

II.2.4. they are not animals to be killed under a national programme for the eradication of diseases, nor have they been vaccinated against the diseases mentioned under point II.2.1.(a) and (b);
ato nuk jane kafshe te eleminuara sipas nje programi nacional te çrrenjosjen e nje semundjeje, dhe nuk jane vaksinuar per semundje permendur sipas pikes II.2.1. (a) dhe (b);

II.2.5. they come from herds that are not restricted under the national legislation pertaining to the eradication of tuberculosis, brucellosis and enzootic bovine leucosis;
ato vijnë nga tufa që nuk janë nën kufizime sipas legjislacionit kombëtar që kanë të bëjnë me çrrënjosjen e tuberkulozit, brucelozës dhe leukozës enzotike të gjedhit;

II.2.6. they come from herds recognised as officially tuberculosis-free ([6]) ([6b])
ato vijnë nga tufa të njohura zyrtarisht si pa tuberkuloz ([6]) ([6b])

and ([1])([7]) either [come from a region which is recognized as officially tuberculosis free;] ([6])
ose [vijne nga rajone te njohura zyrtarisht si te pastra nga tuberkulozi :] ([6])

([1]) or [have been subjected to an intradermal tuberculin test([8]) carried out with negative results within the past 30 days before dispatch to the Republic of Albania;]
ose [i jane nenshtruar nje testi tuberkuline intradermale([8]) që ka rezultuar negativ në 30 ditet e fundit para dërgimit në Republikën e Shqipërisë;]

([1]) or [are less than six weeks old;]
ose [jane me te vegjel se 6 javesh ne moshe;]

II.2.7. they have not been vaccinated against brucellosis and come from herds recognised as officially brucellosis-free ([6]),
nuk jane vaksinuar kunder brucelozes dhe ato vijnë nga tufa të cilat janë të njohura zyrtarisht si të lira nga bruceloza ([6]),

and ([1])([7]) either [come from a region which is recognized as officially brucellosis free;] ([6])
ose [vijne nga rajone te njohura zyrtarisht si te pastra nga bruceloza:] ([6])

([1]) or [have been subjected to at least one test for bovine brucellosis carried out on samples taken within the past 30 days before dispatch to the Republic of Albania;]
ose [i janë nënshtruar të paktën një testi për brucelozën e gjedhit të kryer në mostrat e marra brenda 30 ditëve të fundit para se të dërgohen në Republikën e Shqipërisë;]

([1]) or [are less than 12 months old;]
ose [jane me te vegjel se 12 muaj ne moshe;]

([1]) or [are castrated males of any age;]
ose [jane meshkuj te kastruar te çdo moshe;]

(1) either [II.2.8. They come from herds included in an official system for the control of enzootic bovine leukosis, and in which there has been no evidence either clinical or as a result of a laboratory test of the disease during the past two years.]
Ato vijnë nga tufat e përfshira në një sistem zyrtar për kontrollin e leukozës enzootike të gjedhit, dhe në të cilën nuk ka pasur asnjë provë klinike ose asnjë rezultat të një testi laboratorik të sëmundjes gjatë dy viteve të fundit.]

([1]) or [II.2.8. they come from herds recognized as officially enzootic-bovine-leukosis-free ;] ([6]) ([6a])
ose [vijne nga tufa te njohura zyrtarisht si te pastra nga leukoza enzotike te gjedhit;] ([6]) ([6a])

and ([1])([7])either [come from a region which is recognised as officially enzootic-bovine-leukosis-free;] ([6])
ose [vijne nga rajone te njohura zyrtarisht si te pastra nga leukoza enzotike te gjedhit:] ([6])

([1]) or [have been subjected to an individual test for enzootic bovine leukosis ([6]) carried out with negative result on samples taken within the past 30 days before dispatch to the Republic of Albania;]
ose [i jane nenshtruar nje testi individual per leukozen enzotike te gjedhit ([6])me rezultate negative ne mostra të marra ne 30 ditet e fundit para dërgimit në Republikën e Shqpërisë:]

([1]) or [are less than 12 months old;]
ose [jane me te vegjel se 12 muaj ne moshe:]

Modeli BOV-X *Çertifikata shëndetësore për importin në Republikën e Shqipërisë të kafshëve të llojit gjedh për mbarështim dhe/ose prodhim*

II.2.9. they are / were ([1]) dispatched from their holding(s) of origin, without passing through any market:
ato jane/kane qene ([1]) derguar nga ferma e origjines , pa kaluar nepermjet nje tregu:

([1]) either [directly to Albania,]
ose [direkt ne Shqiperi,]

([1]) or [to the officially authorised assembly centre described under box reference point I.13 situated within the territory described under point II.2.1,]
ose [ne qendra grumbullimi te autorizuara zyrtarisht te pershkruara ne piken I.13 te vendosura brenda një territori si ato te pershkruara ne piken II.2.1,]

and, until dispatched to Albania:
dhe, deri ne dergimin drejt Shqiperise:

(a) they did not come in contact with other cloven-hoofed animals not complying with the health requirements as described in this certificate,
ato nuk kane qene ne kontakt me dythundrak te tjere me kerkesa shendetesore te ndryshme nga ç`eshte pershkruar ne kete çertifikate,

(b) they were not at any place where, or around which, within a 10 km radius, during the previous 30 days there has been a case/outbreak of any of the diseases refered in to point II.2.1;
ato nuk kane qene ne ndonje vend ne te cilin, ose perreth tij ne nje rreze prej 10 km, gjate 30 diteve te fundit nuk ka patur rast / shperthim te ndonje prej semundjeve sipas pikes II.2.1;

II.2.10. any transport vehicles or containers in which they were loaded were cleaned and disinfected before loading with an officially authorized disinfectant;
te gjithe automjetet e ngarkeses apo kontenieret ne te cilin jane ngarkuar kafshet jane pastruar dhe dezinfektuar perpara ngarkimit me nje dezinfektant te autorizuar zyrtarisht;

II.2.11. they were examined by an official veterinarian within 24 hours of loading and showed no clinical sign of disease;
ato jane egzaminuar nga nje veteriner zyrtar ne 24 oret e ngarkimit dhe nuk kane shfaqur asnje shenje klinike te semundjeve;

